



Republika e Kosovës



Komuna Vushtrri

Zyra e Personelit

Nr. 20-nr.326/10

Vushtrri, më 17.09.2010

Në bazë nenit 11 të Ligjit mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës nr.03/L-149, Udhëheqësi i personelit, shpall:

K O N K U R S

Për vendet e punës:

- **Drejtoria për Administratë të Përgjithshme**
- **I.Vendi i punës: Zyrtar për kurorëzime në zyrën e gjendjes civile**

Numri i ekzekutuesve:një (1).

Përshkrimi i shkurtër i detyrave dhe përgjegjësi:

- -Përgatitë të gjithë dokumentacionin për aktin e kurorëzimit ;
- Kryen aktin e kurorëzimit dhe e regjistron në librin amë të të martuarëve ;
- Nën mbikëqyrjen e shefit të ofiqarisë dhe Drejtorit të Drejtorisë zbaton ligjin dhe aktet tjera nënligjore që kanë të bëjnë me gjendjen civile
- -Lëshon çertifikata të martesës dhe të statusit martesor;
- -Harton raport të punës dhe plotëson statistikën;
- Për punën e tij i raporton Drejtorit të Drejtorisë dhe Shefit të Ofiqarsë;

Kualifikimi profesional, aftësitë .

-Fakulteti juridik ose fakulteti filozofik dega gjuhë dhe letërsi shqipe

-Përvoja e punës e dëshirueshme

-Njohja e punës në kompjuter programet Word, excel të obligueshme

Kushtet e dëshiruara:

-Njohja e mirë e drejtshkrimit dhe bukurshkrimit

Periudha e kontratës:

Tre muaj punë provuese me mundësi vazhdimi deri në 2 vite.

Paga:Koeficienti 6

Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë

II. Vendi i punës:Zyrtar për çështje të pronësisë

-Nr. i ekzekutuesve një(1)

Përshkrimi i shkurtër i detyrave dhe përgjegjësi

-Bën pranimin dhe vlerësimin e zbatueshmërisë në elaboratin kadastral të aktgjykimeve, vendimeve dhe kontesteve që kanë të bëjnë me qarkullimin e të drejtës së pronësisë;

-Bën lëshuarjen e vendimeve mbi ndryshimet që bëhen në elaboratin kadastral;

-Nën mbikëqyrjen e Drejtorit të Drejtorisë,kryen edhe punë të tjera profesionale në pajtim me ligjin.

Kualifikim profesional, aftësitë

-Fakulteti juridik;

-Përvoja e punës e dëshirueshme

-Njohja e mirë e punës në kompjuter.

Periudha e kontratës: 3 muaj punë provuese me mundësi vazhdimi deri në 2 vjetë.
Paga;Koeficienti 6.

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit
III.Vendi i punës:Zyrtar për mbrojtje të ambientit
Përshkrimi i shkurtër i detyrave dhe përgjegjësi

-Propozon dhe harton rregullore, në pajtim me ligjin mbi mbrojtjen e ambientit dhe akteve normative plotësuese të nxjerrura për operatorët lokal, që nuk janë nën menaxhimin e shërbimeve publike në fushën e mbrojtjes së mjedisit;

-Bën planifikimin që ka të bëjë me mbrojtjen e mjedisit brenda territorit të komunës, krijimin e masave të arsyeshme lokale për mbrojtjen e mjedisit në mënyrë që të jenë në pajtim me zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, në pajtim me këtë ligj dhe aktet normative.

-Krijimin dhe fuqizimin e masave që kanë për qëllim të kontrollojnë nivelin e zhurmës në qytet;

-Për punën e vetë i përgjigjet Drejtorit të Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit.

Kualifikim profesional, aftësitë;

-Fakulteti i ekologjisë dhe mbrojtjes së ambientit, në mungesë të fakultetit të ekologjisë fakulteti teknologjik

-Njohuri ose trajnime nga fusha e ambientit,

-Njohja e punës në kompjuter.

Periudha e kontratës 3 muaj punë provuese me mundësi vazhdimi deri në 2 vjetë.

Paga;Koeficienti 6

-Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes në mjetet e informacionit publik.

-Paraqitja e kërkesave:

Aplikacionet mund të merren në Zyrën e pranimit ose në faqen e internetit të komunës www.kk.rks-gov.net/vushtrri dhe pastaj dorëzohen në Zyrën e pranimit. Aplikacionit duhet t'i bashkangjesin: **Kopjen e vërtetuar të Diplomës, kopjen e letërnjoftimit dhe certifikatën e lindjes, certifikatën mbi njohjen e punës në kompjuter, si dhe certifikata tjera mbi trajnimet,të jetë banor i Republikës së Kosovës.**

Aplikacionet e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Aplikacionet e pakompletuara do të refuzohen. Kandidatët të cilët hyjnë në përzgjedhjen e ngushtë për intervistë do të informohen me shkrim ose me telefon në afat ligjor. Për çdo informacion kandidatët mund të drejtohen në Sektorin për menaxhimin e personelit (zyra numër 8),nr. i tel. 028-572-416.

Shërbimi Civil i Kosovës i shërben të gjithë popullit të Kosovës, dhe mirëpret aplikacionet prej meshkujve dhe femrave prej të gjitha komuniteteve të Republikës së Kosovës.

Udhëheqësi i Personelit
Bislim Dushi